
AKT - THEMELIMI
I
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“D & F ” Shpk.

Neni 1
Emërtimi i Shoqërisë

1. Ne Tirane me daten 20 Nentor 2023 (*dymije e njezet e tre*) krijohet dhe ushtron veprimtarine e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe vecanerisht me Ligjin Nr.9901 date 14.04.2008 **“Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar**, te ligjit Nr.9723, date 03.05.2007 **“Per regjistrimin e biznesit”** te ndryshuar ,si dhe aktet e tjera ligjore dhe nenligjore qe do te jene ne fuqi gjate veprimtarise se shoqerise, si dhe dispozitat e Statutit te shoqerise qe i bashkengjiten ketij Akti Themelimi, shoqeria me pergjegjesi te kufizuar me emrin: **“D& F ” Sh.p.k**

2. Kjo Shoqëri është Person Juridik në përputhje me Legjislacionin Shqiptar dhe aktiviteti i saj rregullohet duke u bazuar ne Statutin dhe në këtë akt themelimi si dy akte bazë të kësaj Shoqërie.

Neni 2
Selia e Shoqërisë.

1. Selia e kesaj Shoqerie do te jete ne adresen:**Rr.Poligala 03920229,Nr.ndertese.9,Njesia administrative Kashar, Tirane**, me te drejte per te ndryshuar qendren e saj dhe per te hapur dege dhe filiale te tjera ne Republiken e Shqiperise si dhe jashte saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

2. Asambleja e Pergjithshme e Shoqerise mund te krijoje, ndryshoje apo mbylle seli sekondare, agjensi dhe perfaqesi kudo qe e quan te nevojshme edhe jashte shtetit.

Neni 3
Kohezgjatja E Shoqerise

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje afat kohor te pacaktuar, por ajo mund te shperbehet me miratim te Asamblese se Jashtezakonshme sipas rasteve te parashikuara ne Statutin e Shoqerise me miratim te Ortakut te te shoqerise (shperberja dhe likuidimi).

Neni 4 Objekti i Shoqërisë

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë:

4.1. Studim, Projektim, Ristrukturime, Pergatitje dokumentacioni, Administrim, Vleresime, Ekspertiza, Analiza, Certifikime, Trajnime, Krijim të dhenash digjitale etj, për: Objekte sociale dhe ekonomike, Objekte banimi, Objekte industriale dhe Inxhinierike, Objekte të mbrojtjes Lumore dhe Detare, Portuale dhe Aeroporte, Gjeologo-Inxhinierike, Hidroteknike, Elektrike dhe Elektronike. Objekte të sigurisë dhe rendesise së veçante. Transports Hekurudhor, MKZ, Lumor, Detar, Rrugor, Bujqësor dhe Lundrimit Ajror. Prodhime linjash artizanale dhe industriale, Prodhim dhe shpërndarje Energjitike, MKZ, Mbetjeve të ngurta. Plane të detajuara vendore, Mikro dhe Makro plane të zhvillimit arkitekturor, industriale dhe ekonomike, Zona të zhvillimit urban dhe industrial, etj. Objekte kulturore dhe të trashëgimisë kulturore historike, Restaurime, Planifikim urban, Objekte kulturi, Plane të përgjithshme dhe detajuara vendore. Trojeve të buta dhe shpateve me qendreshmeri të ulet, Siperfaqe Tokave bujqësore, Toka të pafrytshme, Pyje, Kullota, Vleresime të ndikimeve në mjedis, Parqe, Pyje. Sherbime të natyrës së projektimit, drejtimit dhe ndihmës teknike të punimeve me personel të kualifikuar, punime topogjodezike, Asistencë teknike, Juridike, Mjekësore etj. Sherbime të natyrave të ngjashme në baze të licencave. Sherbime të Auditimit të Energjisë për Godina sherbimi, Godina Industriale, Godina të rendisë strategjike, ESCO, energji të rinovueshme, etj. Realizimin e punimeve të zbatimit inxhinierike të Transportit, Prodhimit, Tregtimit, Energjisë së Rinovueshme, ESCO, Zonave historike, Godinave me karakter fetar, Historik dhe Monumenteve të Kulturës, Higjieno-Sanitare dhe Sherbimit Spitalor. Ndertim impiantesh eolik, fotovoltajk dhe hidrik për prodhim energjie elektrike. Prodhim dhe shitje energjie elektrike. Hartimin, implementimin e strategjisë së brandit dhe marketingut të turizmit, planin e punës, politikën zhvillimore. Realizimin e studimit të tregut (market research) për të matur dhe analizuar strategjitë e brandit dhe marketingut të turizmit. Hartimin e strategjisë për zhvillimin dhe promovimin e turizmit detar dhe marinave. Administrim i objekteve në bashkëpunësi. Auditim mjedisor. Aktivitete në fushën e teknologjisë, Informacionit, Logjistikës Kompjuterike, dizenjove, teknologji web-I, menaxhim webpage, projektim i sistemit informatik, promovimi i atraksioneve turistike, guida turistike.

4.2 Ushtrim i aktivitetit Privat në fushën e tregtimit të produkteve të naftës dhe nënprodukteve të saj. Tregtimi i mallrave të ndryshëm industrial dhe ushqimor, bujqësor dhe blegtoral, pije freskuese dhe alkoolike, jo alkoolike dhe import-eksport të këtyre mallrave, me shumicë dhe pakicë, import-eksport të artikujve dhe mallrave të dryshme, import-eksport tekstil, hapje dhe shfrytëzim hotelesh, Bar-Kafe, Restorantesh Diskotekash, Qendrash Pushimi dhe Kurative, Qendrash Fitnesi, Hapje Linjash Interneti dhe venien në sherbim të tij për të tretet.

4.3 Import-eksport të hekurit dhe materialeve të ndryshëm ndertimi.

4.4 Import-eksport dhe tregtim të artikujve kancelarik, tregtim me shumicë dhe pakicë të tonerave, tregti letre të formateve të ndryshme, shtypshkrimesh, etj.

4.5 Te ofroj, kryej dhe drejtoj sherbime Sipermarje, projekte dhe veprimtari të të gjitha llojeve, në lidhje dhe në dobi të bashkëpunimit, tregëtisë biznesit, telekomunikacioneve, mjedisit, menaxhimit, konsultimeve Investimeve, Agjensi Komisionere në fushën e Perfaqesimit, Spedicionit, Ndermjetesimit, Marketingut.

4.6 Te krijoj, blej, financoj, investoj, të hyj në marrëdhënie të ndryshme me të tretet, të kryej sipermarje dhe projekte të ofroj sherbime dhe asistencë për riparimin dhe mirëmbajtjen të pajisjeve Audio,...etj, për persona Fizik dhe Juridik.

Neni 5 **Kapitali Themeltar**

1. Kapitali themeltar fillestar i shoqerise eshte : 100.000 LEK (Njeqind mije leke)
2. Ortake Themelues te Shoqerise: Z. Gjolek GUCI Zoterues i 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme 100.000 LEKE (Njeqind mije leke), perben 100% te Kapitalit Themeltar te Shoqerise
3. Kontributi i Ortakut te vetem mund te jete ne para ose ne natyre (Pasuri te Luajtshme/te Paluajtshme apo te drejta).

Neni 6 **Organet E Shoqerise**

1. Organet e shoqerise jane: Asambleja e Ortakeve dhe Administratori.
2. Asambleja e Ortakeve eshte ogani me i larte i shoqerise. Nepermjet ketij emerohet administratori i shoqerise. Administratori i Shoqerise "D & F "" Sh.p.k. , emerohet per nje mandat deri pese vjet 20.11.2023-31.10.2028 me te drejte ripertesitje, Z.Gjolek GUCI i biri i Myslymit.
3. Ortaket themelues dhe administratori ushtrojne te gjitha kompetencat, te drejtat dhe detyrimet, te cilat parashikohen nga statuti i Shoqerise, akti i themelimit dhe legjislacioni shqiptar, per organizimin , drejtimin dhe per te vepruar ne emer dhe per llogari te shoqerise, ne perputhje me objektin e veprimtarise se saj, me perjashtim te atyre kompetencave qe ligji dhe ky statut ja njohin shprehimisht ortakeve.

Neni 7 **Viti Financiar**

Ushtrimi financiar fillon me 1 janar dhe mbaron me 31 Dhjetor te cdo viti. Perjashtimisht viti I pare financiar i cili fillon kur nise veprimtaria e shoqerise do te mbyllet me 31 Dhjetor. Shoqeria e fillon aktivitetin ne momentin e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

Neni 8 **Dispozita te tjera**

1. Marredheniet e punes ne shoqeri rregullohen me ane te kontrates se punes. Per ceshtjet qe nuk rregullohen me kontraten e punes, zbatohen dispozitat e Kodit te Punes. Aktiviteti ekonomik dhe investimet e kesaj Shoqerie mbrohen nga legjislacioni Shqiptar ne fuqi.
2. Per ruajtjen dhe sigurimin e pasurive te saj te luajtshme dhe te paluajtshme kjo Shoqeri mund t'u drejtohet Shoqerive te Sigurimit ne qender dhe deget e tyre, qe Asambleja e Ortakeve do ta vleresoje per te siguruar aktivitetin e Shoqerise.
3. Dispozita me te hollesishme jane parashtruar ne STATUTIN e kesaj Shoqerie e cila shpreh vullnetin e lire te themeluesit.

Neni 9
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin ,do të zgjidhen në mënyrë miqësore dhe do të diskutohen në mënyrë të drejtpërdrejtë , ndërmjet palëve të interesuara , në rast se nuk arrihet në një zgjidhje miqësore të mosmarrëveshjes, ato do t'i besohen Gjykatës Kompetente.

Neni 10
Hartimi i Akt-Themelimit të Shoqërisë


Akt-Themelimi i Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar " D & F " Shpk u hartua në Tiranë , më 20.11.2023.

SHOQËRIA ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"D & F" Sh.p.k.

Ortaket Themelues:

Gjolek GUCI

(emër mbiemër/nënshkrimi)


Gjolek Guci